



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0550

OSHP: 2024/0566

OSHP: 2024/0559

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së OE "SAS" SH.P.K, OE "KSF Major" SH.A, OE "Internat Security Association" SH.P.K kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, Njoftimin e kontratës ose me lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime" me numër të prokurimit 206-24-2841-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, më 21/08/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohen, si të bazuara ankesa e OE "SAS" SH.P.K me nr. 2024/0550, e datës 26.06.2024, ankesa e OE "KSF Major" SH.A me nr. 2024/0559 e datës 28.06.2024, ankesa e OE "Internat Security Association" SH.P.K me nr. 2024/0566 e datës 28.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime" me numër të prokurimit 206-24-2841-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.
2. Anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës si në pikën I të dispozitivit ndërkaq AK duhet ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.
4. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së

Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.03.2024, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime” me numër të prokurimit 206-24-2841-2-2-1 iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës 88,000.00 €.

Me 10.06.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë.

Me datën 14.06.2024 operatorët ekonomik “KSF Major” SH.A dhe "Internat Security Association" SH.P.K. Me 15.06.2024, OE "SAS" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit për dhënie të kontratës. Me datën 18.04.2024 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorëve ekonomik.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “SAS” SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 2024/0550 e datës 26.06.2024, OE ankues “KSF MAJOR” SH.A ka parashtruar ankesë me nr. 2024/0559 të datës 28.06.2024 si dhe OE ankues "Internat Security Association" SH.P.K ka parashtruar ankesë me nr. 2024/0566 të datës 28.06.2024.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 550/24 dhe ankesa nr. 559/24 dhe 566/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues në pretendimet e parashtruara në kërkesën për rishqyrtim

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE "SAS" SH.P.K, OE "KSF Major" SH.A dhe OE "Internat Security Association" SH.P.K

Në NJK dhe ne DT është kërkuar që: Operatori ekonomik me oferte duhet të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet të paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet të përfshijë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për orët e natës, Festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trustin pensionet, Fitimin e OE, TVSH-ne, Totali i ofertës. OE duhet të ketë kujdes në kalkulimin e çmimeve për ore sepse çmimi për ore duhet të variojë varësisht nga ndërrimi i orarit të punës.

Me dëshmi: Analiza financiare e hartuar nga OE Gjithashtu me sqarimet shtese në procedure është kërkuar që: Kompania e cila nuk llogaritet të gjitha shtesat do të eliminohet. Edhe obligim i OE që të respektoj Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës si dhe Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga OE se do të paguaj minimum Pagan Neto jo me pak se 350 euro.

Meqenëse secili OE ka kalkuluar në mënyrën e vet, në mënyrë që të gjitha ofertat të vlerësohen në mënyrë të barabartë, MSh ka kalkuluar minimumin e vlerës së ofertave dmth ato të cilat mbulojnë pagat e punëtorëve sipas Ligjit të Punës. Mënyra se si janë kalkuluar çmimet për ore nga ana e MSh është: Paga Bruto 385.36; Kontributi i punëtorit 5 % 19.27; Tatimi paga 16.09; Paga Neto 350.00. Ky çmim është çmimi pa përfshirë pagesat shtese sipas Ligjit të punës, dmth pa përfshirë koston shtese për pune gjate vikendit, ndërrim të natës, festa, pushimin vjetor.

Pretendimet ankimore të Operatorëve Ekonomik ankues në OSHP

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "SAS" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe Rregullores për Prokurim Publik Ankese në Procedurën e Prokurimit -Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë ka vlerësuar tenderit në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik. Në Dosjen e tenderit Vlera e Parashikuar është 80,000.00€. Lidhur me aktivitetin e Prokurimit me nr 206-24-2841-2-2-1 dhe titull Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime, të inicuar nga AK. Autoriteti Kontraktues ka shpallur fitues OE Besa Security në kundërshtime me ligjin e prokurimit publik në vend se të eliminohet. Pretendimet tona lidhur me Ofertën e OE Besa Security i cili është i papërgjegjshëm. Ka vlerësuar dhe rekomanduar për dhënie të kontratës Operatorin Ekonomik i cili duhet të jetë i papërgjegjshëm duke u bazuar në Analizën Financiare dorëzuar nga OE Besa Security dhe në baze të dosjes së tenderit Aneks 1 Citojmë: Ofruesi i Shërbimeve gjate realizimit të kontratës do të respektoj Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 27 të ligjit të punës - Orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 6:00 numërohen si punë nate. Ndërsa sipas nenit 56 të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si: 30 % në orë për punë gjatë natës; 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 50 % në orë për punë gjatë fundjavës. Autoriteti Kontraktues gjate realizimit të kontratës gëzon të drejtën që nëse vjen deri të hapja e ndonjë pike të re, të kërkojë nga Ofruesi i Shërbimeve që shërbimet e sigurimit të kryej edhe në qendrat e hapura sipas kushteve të kontratës. Çmimi i pagesës për këto qendra do të jete çmimi për njësi i orës së shërbimeve sipas kontratës. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën e kërkesës nga Kryesi i shërbimeve për ndërprerjen e kryerjes së shërbimeve të sigurimit në rast të mbylljes së ndonjëres nga pikat që janë pjesë e specifikacionit teknik të kësaj dosje të

tenderit. - Kërkohej që kompania fituese të ketë minimumin 4 (punëtore) punëtor. Orari i punës

- Instituti Special i Shtimes 24 ore / 7 dite te javës.
- Po ashtu ne DT tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - Citojm
- Operatori ekonomik me oferte duhet te prezantojë një analizë financiar për pagën bazë të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet te paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet te përfshijë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për orët e natës, Festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trustin pensional, Fitimin e OE, TVSH-ne, Totali i ofertës. OE duhet te ketë kujdes ne kalkulimin e çmimeve për ore sepse çmimi për ore duhet te varioj varësisht nga ndërrimi i orarit te punës. Faktet Operatori Ekonomik i Rekomanduar për dhënie te kontratës është i papërgjegjshëm sepse ne Analizën Financiare dhe ne përshkrimin e çmimit, ka dhënë çmime te ndryshme. Analiza Financiare dhe Përshkrimi i çmimit kane dallime Substanciale njëra me tjetrën. Me poshtë kemi paraqitur Analizën Financiare te OE te Rekomanduar për dhënie te kontratës. Ndërrimi 1 - OE Besa Security Paga e Punëtorit Orarin e Punës 08:00-16:00 OE ne Analizën Financiare Paga për një punëtor 453.50€ $453.50 \times 36 = 16,326$ pa Tvsh Ndërrimi 2 OE Besa Security Paga e Punëtorit Orarin e Punës 16:00-24:00 OE ne Analizën Financiare Paga për një punëtor 483.85€ $483.85 \times 36 = 17,418.60$ pa TVSh ndërrimi 3 - OE Besa Security Paga e Punëtorit Orarin e Punës 24:00-08:00 OE ne Analizën Financiare Paga për një punëtor 544.54€ $544.54 \times 36 = 19,603.44$ Pa Tvsh Gjithsej Totali $16,326 + 17,418.60 + 19,603.44 = 53,348.04$ PA TVSH Totali me TVSH $53,348.04 \times 1.18 = 62,950.68\text{€}$. Ndërsa ne Përshkrimi e çmimit pagat për ndërrimet e lart përmendur ne analizën financiare nuk përputhen dhe qe bëjnë ofertën e OE te jetë e papërgjegjshëm me poshtë paraqesim përshkrimin e çmimit Pjesa 1 (Orari 08:00-16:00) Paga e një punëtor pa TVSH 618.31euro ose me TVSH 729.80 (Kalkulimi i pagës ne këtë pozicion nga Operatori ekonomik është $729.80 \times 36 = 26,265.60$) Pjesa 2 (16:00-24:00) Paga e një punëtor pa TVSH $658,98$ euro ose me TVSH 777.60 (Kalkulimi i pagës ne këtë pozicion nga Operatori ekonomik është $777.60 \times 36 = 27,993.60$) Pjesa 3 (24:00-08:00) Paga e një punëtor pa TVSH 742.37 euro ose me TVSH 876.00 (Kalkulimi i pagës ne këtë pozicion nga Operatori ekonomik është $876.00 \times 36 = 31,536.00$) Totali i Përshkrimi te çmimit me TVSH $26,265.60 + 27,993.60 + 31,536.00 = 85,795.20\text{€}$ Nga prezantimi i fakteve dhe argumenteve te analizuara nga ana jone, del se Totali i ofertës nuk përputhet me analizën financiare dhe përshkrimin e çmimit ne përshkrimin çmimit oferta totale është $85,795.20$ me TVSH ndërsa ne Analizën Financiare totali ofertës Totali me TVSH $62,950.68\text{€}$ $85,795.20 - 62,950.68 = 22,844.52$ ose $22,844.52 / 85,795.20 = 26.63\%$ gabimi i kësaj oferte dhe bene te papërgjegjshëm këtë oferte. Ne Aneksin 1- dosjes se tenderit kërkohej që kompania te ketë 4 punëtor, Ofruesi i Shërbimeve gjate realizimit te kontratës do te respektoj Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 27 te ligjit te punës - Orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 6:00 numërohen si punë nate. Ndërsa sipas nenit 56 të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si: 30 % në orë për punë gjatë natës; 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 50 % në orë për punë gjatë fundjavës. Autoriteti Kontraktues gjate realizimit te kontratës gëzon te drejtën qe nëse vjen deri te hapja e ndonjë pike te re, te kërkoj nga Ofruesi i Shërbimeve qe shërbimet e sigurimit ti kryej edhe ne qendrat e hapura sipas kushteve te kontratës. Çmimi i pagesës për këto qendra do te jete çmimi për njësi i orës se shërbimeve sipas kontratës. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues gëzon te drejtën e kërkesës nga Kryesi i shërbimeve për ndërprerjen e kryerjes se shërbimeve te sigurimit ne rast te mbylljes se ndonjëres nga pikat qe janë pjese e specifikacionit teknik te kësaj dosje te tenderit. Kërkohej që kompania fituese të ketë minimumin 4 punëtor. Orari i punës Instituti Special i Shtimes 24 ore / 7 dite te javës. Faktet operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës ka llogaritur ne Analizën Financiare dhe ne përshkrimin e çmimit vetëm për 3 punëtor, operatori ekonomik edhe

ne këtë pike nuk ka respektuar kërkesën e Autoriteti Kontraktues dhe nuk ka respektuar kriteret e dosjes se tenderit. Me këtë ofertat e operatorit ekonomik te rekomanduar për dhënie te kontratës duhet te shpallet i papërgjegjshëm duke u bazuar ne faktet e prezantuar nga ana e kompanisë SAS SHPK.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “KSF Major Sh.A” janë parashtruar si në vijim:

AK ne arsyetimin e Njoftimit për eliminim ka theksuar se Oferta e juaj ne vlere prej: 73,958.40 €, (OE KSF Major sh.a) është e pa përgjegjshme për arsye se nuk i mbulon te gjitha shpenzimet e parapara sipas Ligjit te punës. Ne fund te arsyetimit AK ka konstatuar dhe ka vendosur një prag se te gjitha ofertat mbi 85,104 .00 euro i mbulojnë pagesën e pagës minimale dhe si te tilla plotësojnë te gjitha kushtet e përcaktuara ne dosjen e tenderit.

Parashtruesi i kërkesës për Rishqyrtim ka nënshkruar Deklaratën, ku ka marre përgjegjësinë qe gjate periudhës se ekzekutimit te kontratës do te i paguaj minimumin 350 euro pagën mujore Neto për një punëtor te sigurimit fizik, i cila ka qen kërkesë formale administrative për kualifikim dhe përzgjedhje te OE, si dhe ka ofruar dëshminë dokumentare ne pajtim me kërkesën e AK-se-Analize te detajuar financiare lidhur me pagesën e pagës neto si dhe obligimeve tjera te cilat burojnë nga Ligji i punës dhe Ligji për procedurat Tatimore. Vlen te theksohet se fillimisht AK ka zbatuar gabimisht nenin 31 paragrafin 1 dhe 2, te LPP-se i cili përcakton me sa vijon: Autoriteti kontraktues në raste te tilla kur kërkohen analiza te tilla financiare duhet vetë autoriteti kontraktues te i saktësoj se cilat elemente (pozicione) te shpenzimeve duhet te përfshihen ne analizën financiare dhe te paraqes forma te tilla ne formën Excel te bazuara ne Ligjin e punës dhe Ligjin mbi procedurat e administratës tatimore dhe atëherë te mbetet vetëm obligim i operatoreve ekonomik plotësimi i tyre me çmime dhe ne këtë mënyrë mund te bëhet krahasuesmëria e shpenzimeve (analizave) ne mes te operatoreve ekonomik ofertues. Nëse i qasemi përshkrimit te çmimit shohim se AK nuk ka ndare orët e ndërrimit te natës, orës e festave shtetërore, orët për fund jave, por ne arsyetim te njoftimit për eliminim ka pasqyruar një tabelë e cila përmban vetëm këto te dhëna; Baga bruto 385.36€ Kontributi i punëdhënësit 5% 19.27€ Tatimi ne page 16.09€ Paga neto 350 € Kompanisë enje punëtori i kushton Paga bruto 385.36 € Kontributi i Kompanisë 19.27 € Gjithsejtë shpenzimi për pagën e një punëtori 420.72 € Duke pasur parasysh faktin qe AK është bazuar ne nenin 31 te LPP-se qe ndërlidhet me nenin 17 te Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik duke kërkuar dëshmi dokumentare –Analyze financiare mbi çmimin e dhen te tenderit qe ka te beje ekskluzivisht me ekzekutimin e kontratës ne vijim te kësaj kërkesë do te argumentojmë pretendimet ankimore duke u cituar dispozitat e nenit 31 te LPP-se dhe nenit 17 te Rregullores për Prokurimin Publik. Ne ditën qe te nënshkruhet kontrata ne mes AK-se dhe OE, lajmërohen punëtorët ne ATK punëdhënësi tash me ligj te ATK-se duhet me i lajmëruar punëtorët ne sistem te ATK-se online. Ne momentin e nënshkrimit te kontratës ja kërkon AK-ja Listën e punëtorëve te sistemit te ATK-se qe do te angazhohen për kryerjen e shërbimeve sipas dosjes se tenderit dhe aty dihen sa punëtorët kane me u angazhuar dhe sa është paga e tyre. Pasi nënshkruhet kontrata ne mes AK-se dhe OE ne baze te Rregullores se Prokurimit nenit 70 paragrafët 70.5-70.17, ZKA cakton menaxherin e kontratës dhe mbikëqyrësin e kontratës, këta te fundit duhet te ja kërkon OE te gjitha kontratë e punëtorëve sipas ligjit te punës (ato te cekura me lart dhe te cilat janë kërkuar ne aneksin 1) janë kushte te kontratës dhe janë pjese e realizimit te kontratës qe duhet ta menaxhon menaxheri i kontratës me OE, se a i ka përmbush kushtet e tenderit qe kane qene ne specifikim teknik aneksin 1, a janë plotësuar kushtet e ligjit te punës qe janë kërkuar ne DT, a është plotësuar paga e punëtorit sipas kërkesës se dosjes e kështu me radhë. Vlen te theksohet se sipas nenit 31 Ekzekutimi i kontratave, paragrafi 2 i këtij neni “Autoritetet Kontraktuese mundtë referohen në kushtet e

performancës së kontratës në veçanti atyre të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e punëtorëve dhe kushteve të punës të cilat janë në fuqi me ligj apo me rregullore në Kosovë „me kusht që këto kushte të përfshihen në shpalljen e kontratës dhe në specifikimet teknike. Autoriteti kontraktues mund të vendosë, ndër të tjera, kushte specifike në kontratë të cilat lejojnë që objektivat sociale të merren parasysh”. Sidoqoftë pavarësisht nga përgatitjet e analizave financiare nga ofertuesit kërkesat e zbatimit të ligjit të punës dhe të ligjit mbi procedurat e Administratës Tatimore në Kosovë në bazë të ligjeve në fuqi janë obligime ligjore të mbikëqyrjes nga Inspektoratet përkatëse të ATK-së dhe Inspektoratit të Punës dhe duhet të zbatohen në harmoni me ligjet në fuqi.

Bazuar në aneksin 1 të dosjes së tenderit shohim se AK ka përshkruar në mënyrë specifike obligimet e OE gjatë ofrimit të kryerjes së shërbimeve të sigurimit fizik në objektet e Institutit si dhe ka theksuar se OE i cili do të shpërblehet me kontratë është i obliguar që të respektoj dispozitat e Ligjit të Punës dhe Ligjit për sigurimet private të sigurisë. Citoj paragrafin e fundit të aneksit 11 të dosjes së tenderit; “Ofruesi i Shërbimeve gjatë realizimit të kontratës do të respektoj Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 27 të Ligjit të punës - Orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 6:00 numërohen si punë nate. Ndërsa sipas nenit 56 të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si: 30 % në orë për punë gjatë natës; 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 50 % në orë për punë gjatë fundjavës. Autoriteti Kontraktues gjatë realizimit të kontratës gëzon të drejtën që nëse vjen deri të hapja e ndonjë pike të re, të kërkojë nga Ofruesi i Shërbimeve që shërbimet e sigurimit të kryej edhe në qendrat e hapura sipas kushteve të kontratës. Çmimi i pagesës për këto qendra do të jete çmimi për njësi i orës së shërbimeve sipas kontratës. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues gëzon të drejtën e kërkesës nga kryesi i shërbimeve për ndërprerjen e kryerjes së shërbimeve të sigurimit në rast të mbylljes së ndonjëres nga pikat që janë pjesë e specifikimit teknik të kësaj dosje të tenderit. Kërkohet që kompania fituese të ketë minimumin 4 (punëtore) punëtor. Orari i punës · Instituti Special i Shtimes 24 ore / 7 dite të javës” Bazuar në Përshkrimin të çmimit i cili ka qenë pjesë përbërëse e tenderit shohim se AK nuk ka vepruar në harmoni me kërkesën e vet, të përcaktuar në aneksin 1 të dosjes së tenderit. AK ka përcaktuar si obligim për të kalkuluar çmimin total të tenderit vetëm çmimin për muaj me TVSH si dhe Çmimin total për 36 muaj me TVSH për numrin total të orëve (240 ore në muaj). Pretendojmë se nuk ka standard të analizës financiare në kërkesat e dosjen e tenderit që është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë rast AK –ja që ka kërkuar si kriter analize financiarë mundet të jete subjektive që ka të drejtë që çdo anëtarë i komisionit të vlerësimit mundet të vendos sipas mendimit të vetë. Në bazë të kërkesës që është përcaktuar në dosjen e tenderit; “Operatori ekonomik me oferte duhet të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet të paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri të çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet të përfshijë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për orët e natës, festat shtetërore, pushimet vjetore, trustin pensional, fitimin e OE, TVSH-ne, totali i ofertës” OE duhet të ketë kujdes në kalkulimin e çmimeve për ore sepse çmimi për ore duhet të variojë varësisht nga ndërrimi i orarit të punës. Të drejtat e punëtorëve që janë përcaktuar me ligj të punës, këto të drejta të cilat janë specifikuar në specifikim teknik dhe kërkojnë të inkuorohen në kontrata të punëtorëve. Vlen të theksohet se të drejtat e punëtorëve që janë përcaktuar me ligj të punës, këto të drejta të cilat janë specifikuar në specifikim teknik dhe kërkojnë të inkuorohen në kontrata të punëtorëve. Pas përfundimit të aktivitetit menaxheri i kontratës kur të nënshkruhet kontrata ndërmjet AK-se dhe OE, pastaj AK ua kërkon kontratat krejt punëtorëve të OE me kushtet, specifikimet teknike që janë kërkuar në dosjen e tenderit, nëse nuk i ka atëherë kërkohet të plotëson OE, gjithashtu çdo punëtor i ri që OE e angazhon në

kompani duhet ta njoftoj menaxherin e kontratës që te ju jepet leja ne objekt e shume kushte tjera. Kërkesa qe ka gene ne dosje te FTD-ja te pika 9.1, ligji i punës Nr. 03 L-212 1 unë si OE kam nxjerr disa te drejta te përcaktuara ne Ligj te pune qe ju kane referuar kushtet e kontratës. Si nen kryesor është nenit 10, paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.2, dhe nenit 11 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 01.12.2010, punëdhënësi dhe punëmarrësi, si palë në marrëdhënien juridike të punës, hyjnë në Kontrate te punës me Afat te caktuar ose pa caktuar. 2.Punonjësi do të kryejë detyrat si punëtor i sigurimit. Detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit janë përshkruar në përshkrimin e punës, i cili është pjesë e kësaj kontrate si Aneksin 1 te DT. Punonjësi do të kryej detyrat në Institutin Special ne Shtime 3.Punonjësi krijon marrëdhënie pune me kohë të plotë. Orari i plotë është: 8 orë pune në ditë, 40 orë pune në javë. 4. Punëtorët do të marrin pagë bazë nga punëdhënësi së paku një herë në muaj në këmbim të punës së kryer, në nivelin ose me vlere 350 € neto, sipas dosjes se tenderit datës.

Neni 56 përcakton 5.Punonjësi ka të drejtë në pagë shtesë si përqindje e pagës bazë: 1) 20% në orë për shërbimin e kujdestarisë; 2) 30% në orë për turnin e natës; 3) 30% në orë për jashtë orarit; 4) 50% në orë për punë gjatë festave, dhe 5) 50% në orë për punë gjatë fundjavës. 6.Punonjësi ka të drejtën e kompensimit të pagës pa punuar, në rastet e mëposhtme: 1) gjatë pushimeve kur nuk ka punë; 2) gjatë shfrytëzimit të pushimit vjetor; 3) gjatë trajnimit dhe zhvillimit profesional të caktuar për, dhe 7. Punonjësi ka të drejtën e kompensimit të pagës bazë gjatë pushimit mjekësor: 1) 100% në rast të përdorimit të pushimit të rregullt mjekësor, mbi bazën deri në 20 ditë pune brenda një (1) viti, si dhe te drejtat tjera te mungesës nga puna me kompensim. Pra siç po shihet disa nga këto kërkesa unë si përfaqësues i OE Meb LLC i kam nxjerr nga Ligji i Punës qe është thirr AK-ja dhe disa qe janë kërkuar ne dosjen e tenderit janë kushte te kontratës, i takojnë Ligjit te punës dhe nuk duhet te jene si kriteret te vlerësimit te dosjes se tenderit. Gjithashtu as si pjese e analizës financiare pasi nuk mundesh ti parashihen ne analizë financiar te gjitha kushtet e kontratës se çdo OE i ka kushtet e veta dhe shpenzimet e veta, fitimin e vet e kështu qe vlerësimi i analizës financiare nuk duhet te jete si kriter i vlerësimit, gjithashtu ne baze te ligjit për vlerësim te kushteve te punës ne mes punëdhënësi dhe punëmarrësi si palë në marrëdhënien juridike të punës e qe hyjnë në Kontrate te punës i takon ligjit te punës, a është respektuar Ligji i punës, këtu vendosin exoficio apo me kërkesë (ankese) te punonjësve, Organet kompetente administrative te shtetit (Inspektorati i punës, Inspektoret e ATK-se) dhe ne fund Gjykata duke u bazuar ne kushtet e kontratës. Pretendoj se Analiza financiare qe është kërkuar si kriter është ne kundërshtim me neni 17.23 deri 17.26 pasi këto nene ju referohet kushteve te kontratës e ne këtë rast nuk është përgjegjësi e AK-se ti shqyrtoj. Ne analize financiare nuk munden me u caktuar te gjitha kërkesat qe kërkohe me ligjin e prokurimit, me ligjin e punës, me ligjin e lehonisë me ligjin mbi sigurimet e punëtorëve, me ligjin e festave zyrtare e kështu me radhe te gjitha këto kriteret qe janë kërkuar ne baze te ligjit dhe rregullores janë kushte te kontratës ne mes punëdhënësit dhe punëmarrësit qe nuk duhet te jene kriteret te vlerësimit. Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara pretendojmë se AK gjate zhvillimit te procedurës se vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te tenderit ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-se. Neni 60 Kriteret për dhënie kontratës Pretendojmë se AK përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate një OE i cili ne është rekomanduar për shpërblym te kontratës dhe ka ofruar çmimin me te larte 85,795.20 euro ne krahasim me çmimin e ofruar nga parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim i cili ka ofruar çmimin me te ulte ne vlere prej 73,958.40 €, dhe është eliminuar, ka bere shkelje te dispozitës se nenit 60 te LPP-se, duke mos respektuar Kriterin për dhënie të kontratës i cili ka qen i përcaktuar ne Njofitim për kontrate dhe ne dosje te tenderit; Çmimin më të ultë, i tenderit te përgjegjshëm. Citoj dispozitën e nenit 60 te LPP-se; 1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me

çmimin më të ulët; Duke pasur parasysh faktet e lartshënuara si dhe dispozitat e nenit 60 të LPP-se pretendojmë se AK ka bërë shkelje të dispozitave të këtij neni me rastin e marrjes së Vendimit për dhënie të kontratës për OE i cili për nga çmimi është më të lartë, pra AK nuk ka respektuar Kriterin për dhënie të kontratës. Neni 61, Tenderët Jo-Normalisht të ultë Pretendojmë se AK fillimisht përmes rekomandimit të Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit dhe me vone përmes aprovimit të ZPP-se, ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 61, paragrafi 3, të LPP-së dhe me këtë rast gabimisht ka vlerësuar se çmimi i dhënë në tender është çmim i cili nuk është në pajtim me kërkesën e AK-se dhe si rrjedhojë e kësaj ka vlerësuar tenderin në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik. LPP në RK në nenin 61 të LPP-së në mënyrë detale parasheh kushtet të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që të kualifikohet një tender si tender me çmim Jo –Normalisht të ultë. Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka dështuar në vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit, duke vlerësuar gabimisht ofertën e OE të eliminuar si ofertë me çmim Jo-Normalisht të ultë edhe përkundër ofrimit të Deklaratës së nënshkruar dhe vulosur se OE që në rast se shpërblehet me kontratë, do të i përmbush të gjitha kërkesat e AK-se, sa i përket pagesës së pagave dhe tatimeve të aplikueshme në Kosovë, të dhëna mbi arsyeshmërinë e çmimit të dhënë në ofertën financiare si dhe do të respektoj dispozitat e Ligjit të punës. Pretendojmë se oferta financiare, ka qenë ofertë reale dhe e bazuar në çmimet reale në tregun e punës së Kosovës. Neni 108/A, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve Pretendojmë se AK me rastin e trajtimit të Kërkesës për rishqyrtim ka bërë shkelje të nenit 108A. Bazuar në datën e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim të OE “Besa Security” sh.p.k e cila ka qenë 15 prill 2024 shohim se AK me datë 18 prill 2024 e ka pranuar kërkesën si të lejueshme edhe përkundër faktit që OE nuk ka pasur të drejtë që në ditën e hapjes së tenderit të parashtrij kërkesë për rishqyrtim. AK është dashur të aplikoj nënin 108A paragrafin 3 i cili përcakton me sa vijon; Citoj paragrafin 3 dhe 3.1 të nenit 108A; 3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme: 3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.

Duke u bazuar në kërkesën për rishqyrtim të OE” Besa Security” sh.p.k të parashtruar me 15.04.2024 si dhe në Vendimin mbi miratimin e kërkesës nga ana e AK-se të datës 18.04.2024 si dhe faktin që afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë 15.04.2024 me ora 14:00, pretendojmë se AK ka bërë shkelje të nenit 108A të LPP-së. II/ Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik të datës 01.11.2022. Neni 41, Tenderët jo-normalisht të ultë pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka dështuar në zbatimin e nenit 41 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik të datës 01.11.2022. Nëse i referohemi nenit 41.1 të kësaj Rregulloreje shohim se si duhet të veprohet, kur AK konsideron se një ofertë e dorëzuar duhet të trajtohet si ofertë e pa realizueshme gjatë implementimit të kontratës dhe me çmim që sipas LPP-se dhe Rregullores së Prokurimit publik trajtohet Çmim-normalisht i ultë. Në nenin 41 të kësaj Rregulloreje koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të parë duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës. Baza në paragrafin 41.2 Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulët, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët. Bazuar në platformën e -prokurimit nuk kemi vërejtur se AK, i është drejtuar OE me Letrën standarde për tenderues jo-normalisht të ultë siç e përcakton LPP dhe legjislacioni dytësor si dhe obligimin tjetër ligjor që të njoftohet KRPP-ja Në këtë situatë AK është i obliguar që; të kërkojnë nga operatorët ekonomik

për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, si dhe ta i përmbahet kushteve të përcaktuara si në vijim; i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. Ne baze të letrave standarde shohim se 4 OE janë eliminuar ne baze të një pragu i cili është caktuar nga ana e Komisionit në mënyrë të kundërligjshme dhe atë me një vlerë prej 85,104 .00 euro shohim se AK përveç që ka vënë kritere të përzgjedhjes në mënyrë të kundërligjshme, edhe procedurën e vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit e ka bërë në mënyrë të kundërligjshme. Autoriteti kontraktues është dashur të veprojë në pajtim me nenin 41.4 të Rregullores së cili përcakton me sa vijon; 41.4 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së Pretendojmë se AK nuk ka baze ligjore për të trajtuar ofertën me çmim jo normalisht të ulte konform nenit 41.3 të Rregullores që ndërlidhet me nenin 61 të LPP-se. Ne baze të formulës çmimi i Kompanisë së Sigurimit fizik Major nuk është 30 % më i ulte se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm që janë me shume se tre (në pikëpamje të plotësimit të kushteve formale administrative). Çmimi i OE K.S.F ”Major nuk është 10% më i ulte se çmimi i tenderit të dytë. Me fjale të tjera nuk ka baze ligjore për tu trajtuar si oferte e pa përgjegjshme në kuptim të arsytimit të çmimi i dhënë në vlerë prej 73,958.40 euro për pagesën e 4 punëtorëve me page neto prej 350.00 euro për të i mbuluar shpenzimet për pagesën e kontributeve dhe tatimeve të aplikueshme në Kosovë, dhe nuk ka baze ligjore për tu eliminuar nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit. Bazuar në Njoftimin për eliminimin nga aktiviteti i prokurimit si dhe bazuar në dispozitat e nenit 41 të Rregullores për Prokurimin Publik që ndërlidhet me nenin 61 të LPP-se pretendojmë se AK gjatë procedurës së vlerësimit ekzaminimit, krahasimit të tenderëve ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPP-se, Rregullores për Prokurimin Publik dhe dispozitat e Dosjes së tenderit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Internat Security Association" SH.P. K janë parashtruar si në vijim:

Pasi që kompania jonë është palë me interes në këtë Aktivitet të Prokurimit , po ju dërgojmë këtë ankesë për të shpjeguar se OE i shpallur me vendim të AK si OE i suksesshëm në këtë AP nuk i plotëson kushtet e kërkuara nga AK për llogaritjen e pagave dhe shtesave të dala nga ligji i punës, për të argumentuar këtë pretendim tonin po ju japim shpjegimet si më poshtë: Kompania Besa Security sh.p.k, gjatë llogaritjes siç e shifni në tabelën si më poshtë ka cekur të gjitha shtesat e vendosura në dosjen e tenderit përpos shtesave të fundjavës të cilat në tabelën e llogaritjes kanë vlerën 0.00 euro, dhe si e tillë ky lëshim është dashur të vërehet nga AK dhe oferte e Besa Security të konsiderohet si financiarisht e papërgjegjshme. Dëshmi e kërkesës së AK për llogaritjen e vikendeve është kërkesa të dosja e tenderit “Operatori ekonomik me oferte duhet të prezantojë një analizë financiare për pagën bazë të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet të paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri të çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet të përfshijë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për orët e natës, festat shtetërore, pushimet vjetore, trustin pensional, fitimin e OE, TVSH-ne, totali i ofertës. OE duhet të ketë kujdes në kalkulimin e çmimeve për ore sepse çmimi për ore duhet të variojë varësisht nga ndërrimi i orarit të punës” dhe Aneks 1 specifikimet teknike të detyrueshme. “Ofruesi i Shërbimeve gjatë realizimit të kontratës do të respektoj Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 27 të ligjit të punës - Orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 6:00 numërohen si punë nate. Ndërsa sipas nenit 56 të punësuarit i takon paga shtesë

në përqindje të pagës bazë, si: 30 % në orë për punë gjatë natës; 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 50 % në orë për punë gjatë fundjavës.” Kurse në tabelat e llogaritjes së bëra nga Besa Security sh.p.k, të gjitha fundjavat janë të pa llogaritura shih tabela si më poshtë. Po të ishin llogaritur në tabelë edhe vikendet çmimi për orë i kompanisë Besa Security sh.p.k do të ishte 3.85 euro për orë. Andaj si e tillë oferta nuk guxon të kalojë duke anashkaluar kompaninë tonë e cila ka bërë llogaritje ku ka përfshirë të gjitha elementet e kërkesës së dosjes së tenderit në analizë. Po që se do të ishin llogaritur vikendet sipas kërkesës së AK atëherë kompania Besa Security do të kishte çmimin shumë më të lartë dhe kjo do të bënte që ne të radhitemi me çmimin e ofertës sonë e cila do të ishte më e ulët se e tyre. Kurse te llogaritja e juaj (Autoriteti Kontraktues), keni bërë llogaritjen tabelare mirëpo ju keni bërë një gabim te kontributet pensionale llogariten pas shtesave duke pas parasysh se edhe ato hyjnë ne paga.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27.06.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 550/24, 559/24 dhe 566/24 ndërsa me datë 02/07/2024 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 550/24 është dorëzuar raporti i super-ekspertizës me rekomandimet si në vijim: “eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 550/24 të operatorit ekonomik "SAS" SH.P. K

Përgjigje në Pretendimi nr. 1: Pretendimi ankimor i OE ankues ne këtë aktivitet te prokurimit ka te beje me analizën financiare te OE te rekomanduar për kontrate dhe mënyra se si është bere përlllogaritja e kërkesave te FDT prandaj do te trajtohet si një pretendim i vetëm. Sipër kërkesës se FDT është kërkuar: Operatori ekonomik me oferte duhet te prezantojë një analizë financiare për pagën bazë të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet te paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet te përfshijë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për orët e natës, Festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trustin pensional, Fitimin e OE, TVSH-ne, Totali i ofertës. OE duhet te ketë kujdes ne kalkulimin e çmimeve për ore sepse çmimi për ore duhet te varioj varësisht nga ndërrimi i orarit te punës. Analiza financiare e hartuar nga OE Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me dallimet ne përshkrimin e çmimeve dhe ne analizën financiare eksperti shqyrtues pas analizës se fakteve sqaron se me përshkrim te çmimeve OE i rekomanduar për kontrate ka dhënë totalin prej 85,843.58 derisa ne analizën financiare sipas përlllogaritjes del se totali është 62,950.69 qe rezulton se ka një ndryshim prej 22,892.9 me e vogël ne analizë. Duke marr parasysh kërkesat e FDT ne te cilën është kërkuar qe OE ti ketë minimum 4 punëtor, llogaria e OE te rekomanduar për kontrate rezulton se është llogaritur vetëm për tre punëtor. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues se analiza financiare pasqyron llogaritë vetëm për tre punëtor është i bazuar, ndërsa sa i përket trajtimit te ofertës sipas nenit 40.9 dhe 40.10 te RRPP 001/2022 eksperti shqyrtues vlerëson se analiza financiare është kërkesë e AK-ve ne mënyrë qe te analizojnë se a është bere llogaritja ne përputhje me Ligjin e Punës ndërsa RRPP çështjen e gabimeve aritmetike e mbulon ne kuptimin

e çmimeve njësi dhe çmimit total të dhënë në formularin e tenderit dhe në përshkrim të çmimeve dhe nuk mund të aplikohet këtu. Për më tepër çmimi i formularit të tenderit dhe çmimet njësi janë në përputhje me nenin 40.10 paragrafi b) kështu që pretendimi në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm. Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar edhe dy ankesa tjera 2024/559 dhe 2024/566 dhe duke pas parasysh rekomandimet në ankesat në fjalë eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet janë të bazuara dhe rekomandon që të anulohet njoftimi për vendim i AK-se dhe aktivitetit të rivlerësohet duke u marr për bazë kriteret e përcaktuara me FDT dhe ofertat e dorëzuara me analizën e OE -ve pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit e jo të merret një standard i cili nuk ka qenë pjesë e dokumenteve të tenderit në fazën e tenderimit dhe për të cilin OE nuk kanë pas njohuri.

Raportin e super - ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues nuk deklaruar, ndërsa nga tre OE anukes vetëm operatori ekonomik "International Security Association" sh.p.k është deklaruar se pajtohet me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 559/24 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: “eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 559/24 të operatorit ekonomik “KSF Major” SH.A

Përgjigje në Pretendimi nr. 1: Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me vlerësimin e ofertave në kundërshtim me nenin 59 të LPP-se dhe pretendon se vlerësimi është bërë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Eksperti shqyrtues pas administrimit të provës njoftim për vendim të AK-se vlerëson se gjatë vlerësimit dhe marrjes së vendimit AK është bazuar në analize financiare të brendshme e cila nuk ju është prezantuar OE-ve gjatë fazës së tenderimit dhe e cila ka rezultuar që OE-te pjesë të këtij aktivitetit të prokurimit të trajtohen në mënyrë jo të barabartë dhe në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-se si dhe nenin 40.2 të RRPP 001/2022 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Prandaj duke u bazuar në sqarimet si më lartë eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi në këtë pikë është i bazuar. Përgjigje në Pretendimi nr. 2: Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me analizën financiare dhe se OE pretendon se AK ka zbatuar gabimisht nenin 32 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-se, dhe se pretendon se AK nuk ka vepruar në harmoni me kërkesën e vet kur e ka përcaktuar mënyrën e kalkulimit në përshkrimin e çmimeve dhe se analiza financiare e kërkuar nuk ka një standard dhe mund të jetë subjektive për komisionin e vlerësimit. Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE në këtë pikë ka të bëjë me dokumentet e tenderit dhe kushtet e kërkuara me FDT, prandaj është dashur të paraqes ankesa sipas nenit 60.1 a) para afatit të fundit për dorëzim të ofertave dhe se pretendimi ankimor në këtë pikë nuk është i bazuar. Përgjigje në Pretendimi nr. 3: Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me vlerësimin e AK-se dhe se OE ankues pretendon se AK ka vlerësuar ofertat si jonormalisht të ultë në kundërshtim me nenin 41 të RRPP 001/2022 duke eliminuar OE në këtë aktivitet të prokurimit në bazë të një pragu të përcaktuar nga ana e komisionit të vlerësimit. Eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit

te ofertave nuk e ka marre për baze bazën ligjore bazuar në nenin 41 të RPP 001/2022 sidoqoftë eksperti shqyrtues vlerëson se këtij pretendimi i është dhënë përgjigje në pjesën e dytë të përgjigjes në pretendimin e parë e cila është vlerësuar e bazuar. Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar edhe dy ankesa tjera 2024/550 dhe 2024/566 dhe duke pas parasysh rekomandimet në ankesat në fjale eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet janë të bazuara dhe rekomandon që të anulohet njoftimi për vendim i AK-se dhe aktivitetit të rivlerësohet duke u marr për bazë kriteret e përcaktuara me FDT dhe ofertat e dorëzuara me analizën e OE -ve pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit e jo të merret një standard i cili nuk ka qenë pjesë e dokumenteve të tenderit në fazën e tenderimit dhe për të cilin OE nuk kanë pas njohuri.

Lidhur me ankesën nr. 566/24 është dorëzuar raporti i super-ekspertizes me rekomandimet si në vijim: “eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 566/24 të operatorit ekonomik "Internat Security Association" SH.P.K

Përgjigje në Pretendimi nr. 1: Pretendimi ankimor i OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit ka të bëjë me analizën financiare të OE të rekomanduar për kontrate dhe mënyra se si është bërë përllogaritja e kërkesave të FDT prandaj do të trajtohet si një pretendim i vetëm.

Sipër kërkesës se FDT është kërkuar: Operatori ekonomik me oferte duhet të prezantojë një analizë Përgjigje në Pretendimi nr. 1: Pretendimi ankimor i OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit ka të bëjë me analizën financiare të OE të rekomanduar për kontrate dhe mënyra se si është bërë përllogaritja e kërkesave të FDT prandaj do të trajtohet si një pretendim i vetëm. Sipër kërkesës se FDT është kërkuar : Operatori ekonomik me oferte duhet të prezantojë një analizë financiarë për pagën bazë të pasqyruara më të gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit të Punës Nr.03 L-212. OE duhet të paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri të çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet të përfshijë se paku Pagat bazë neto për punëtorë, Pagesat shtesë për orët e natës, Festat shtetërore, Pushimet vjetore, Trustin pensional, Fitimin e OE, TVSH-ne, Totali i ofertës. OE duhet të ketë kujdes në kalkulimin e çmimeve për ore sepse çmimi për ore duhet të varioj varësisht nga ndërrimi i orarit të punës. Analiza financiare e hartuar nga OE Sa i përket pretendimit të OE ankues që ka të bëjë me pjesën e llogaritjes së vikendeve në analizën financiare të OE të rekomanduar për kontratë eksperti shqyrtues ka administruar provat, dosjen e tenderit, përshkrimin e çmimeve, ofertën e OE të rekomanduar për kontrate dhe sqaron se me përshkrim të çmimeve AK në pozicionet e përshkrimit të çmimeve ka specifikuar se numri total i orëve në ditë është 8 ndërsa numrin e ditëve në muaj e ka llogaritur me 30 ditë pune e cila ka rezultuar në 240 ore pune, që d.t.th se në tabele kanë llogaritur edhe ore fundjavat e cila sipas ligjit të punës neni 56 par 2.5 llogaritet 50% në ore pune gjatë fundjavës. OE i rekomanduar për kontrate në analizën financiare nuk e ka llogaritur koston e shtesave gjatë punës së fundjavës që është në kundërshtim me kërkesën e FDT dhe Ligjin e Punës 03 L/212 dhe se pretendimi në këtë pikë është i qëndrueshëm. Sa i përket analizës së AK e cila është marre si bazë për përcaktimin e OE që do të shpërblehet e publikuar me njoftimin për vendim eksperti shqyrtues vlerëson se në tabelën e parë ku është llogaritur gjithsejtë shpenzimi për pagën e një punëtori totali nuk është i saktë sepse është dashur të jete 404.63. Po ashtu në tabelën e llogaritjes sipas AK-se gjatë llogaritjes së kontributeve AK në të tri ndërrimet e llogaritura ka llogaritur kontributin bazë e cila është në kundërshtim me LP 03 L/212 sepse kontributi llogaritet në pagën bruto e cila varësisht prej shtesave ndryshon dhe nuk mund të jete e njëjtë sikur në tabelën e AK-se, rrjedhimisht duke

dhënë një rezultat sipas te cilit është bazuar ne vlerësimin e ofertave dhe e cila nuk ka qenë pjesë e FDTse gjate fazës se tenderimit e cila ka rezultuar qe OE-te pjesë te këtij aktivitetit te prokurimit te trajtohen ne mënyrë jo te barabarte dhe ne kundërshtim me nenin 7 dhe 59 te LPP-se si dhe nenin 40.2 te RRPP 001/2022 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Prandaj duke u bazuar ne sqarimet si me larte eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ne këtë pikë është i bazuar. Lidhur me këtë aktivitet te prokurimit janë dorëzuar edhe dy ankesa tjera 2024/559 dhe 2024/5550 dhe duke pas parasysh rekomandimet ne ankesat ne fjale eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet janë të bazuara dhe rekomandon qe te anulohet njoftimi për vendim i AK-se dhe aktivitetit të rivlerësohet duke u marr për bazë kriteret e përcaktuara me FDT dhe ofertat e dorëzuara me analizën e OE -ve pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit e jo të merret një standard i cili nuk ka qenë pjese e dokumenteve te tenderit në fazën e tenderimit dhe për te cilin OE-te nuk kanë pas njohuri.

Raportin e super-ekspertizës Nr. 559/24 e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues nuk është përgjegjës, e as operatori ekonomik ankesues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur. Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatoreve Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorëve Ekonomik duhet të aprovohen si të bazuara ndërkaq vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe procedura e prokurimit ti nënshtrohet rivlerësimit.

Paneli shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore të ankueseve (të sipërcituar) kanë të bëjnë me OE të rekomanduar për kontrate ku sipas ekspertit shqyrtues i rekomanduar për kontratë ka dhënë totalin prej 85,843.58 derisa në analizën financiare sipas përlllogaritjes del se totali është 62,950.69 që rezulton se ka një ndryshim prej 22,892.9 me e vogël në analizë. Duke marrë parasysh kërkesat e FDT në të cilën është kërkuar që OE të ketë minimum 4 punëtor, llogaria e OE të rekomanduar për kontrate rezulton se është llogaritur vetëm për tre punëtor.

Paneli shqyrtues konstaton se AK-se gjatë vlerësimit dhe marrjes së vendimit është bazuar në analize financiare të brendshme e cila nuk ju është prezantuar OE-ve gjatë fazës së tenderimit dhe e cila ka rezultuar që OE-te pjesë të këtij aktiviteti të prokurimit të trajtohen në mënyrë jo të barabartë dhe në kundërshtim me nenin 7 dhe 59 të LPP-se si dhe nenin 40.2 të RRPP 001/2022. Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do të jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK nuk ka vepruar në harmoni me kërkesën e vet kur e ka përcaktuar mënyrën e kalkulimit në përshkrimin e çmimeve dhe se analiza financiare e kërkuar nuk ka një standard dhe mund të jetë subjektive për komisionin e vlerësimit

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankesave të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatorët ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin

e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimin të këtij vendimi

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - "SAS" SH.P.K., KSF MAJOR SH.A.**
- Arkivës së OSHP-së: